



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 38.

Prishtinë, më 01.03.2016, në orën 11:00.

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Xhavit Haliti, Luljeta Veselaj- Gutaj, Bislim Zogaj, Slobodan Petroviq dhe Kujtim Paqaku.

Munguan: Ilir Deda, Arben Gashi, Vjosa Osmani, Valdete Bajrami dhe Time Kadrijaj.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi znj. Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit.

Në mbledhje u propozua ky:

Rend i Ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më: 07.12.2015, 10.12.2015, 14.12.2015, 25.01.2016 dhe 02.02.2016;**
- 3. Shqyrtimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2016;**
- 4. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit (PKZMSA);**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-060 për Mjekësin Ligjore, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-07 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-064 për Patentë -shofer, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**

9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

10. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-062 për siguri në punë në veprimtarinë minerare, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

11. Të ndryshme.

Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit pasi konstatoj se janë plotësuar kushtet për punë hapi mbledhjen.

Fillimisht prezantoi dhe i uroi mirëseardhje anëtarit të ri të Komisionit, z. Bislim Zogaj.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2.Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më: 07.12.2015, 10.12.2015, 14.12.2015, 25.01.2016 dhe 02.02.2016

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më: 07.12.2015, 10.12.2015, 14.12.2015, 25.01.2016 dhe 02.02.2016, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Planit të Punës së Komisionit për vitin 2016

Kryetarja theksoi se Plani i Punës së Komisionit për vitin 2016 është hartuar së pari si draft dhe në një takim me shoqërinë civile janë dhënë disa propozime, të cilat janë inkorporuar në këtë plan.

Për miratim është nxjerrë në komision dy herë, por për mungesë kuorumi nuk ka mundur të miratohet.

Në vazhdim e hodhi në votim planin për miratim.

Kujtim Paqaku- Tha se në këtë Plan është bërë një lëshim teknik, sepse në mbledhjen e kaluar të komisionit kam propozuar që aktiviteti „Iniciativa për krijimin e rrjetit të romëve në rajon, në Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë”, kërkoj të futet në plan të punës ky aktivitet në muajin prill, e jo në muajin korrik, sepse tha se në muajin prill është një ditë e rëndësishme për komunitetin rom.

Pas votimit kryetarja konstatoi se Komisioni një zëri miratoi Planin e Punës së Komisionit për vitin 2016 me ndryshimin e propozuar nga deputeti Kujtim Paqaku.

4. Shqyrtimi i Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit (PKZMSA)

Kryetarja - Tha se PKZMSA kërkon përkushtim dhe punë sistematike dhe të koordinuar në mënyrë që MSA të zbatohet dhe efektet të jenë sa më pozitive për Republikën e Kosovës.

PKZMSA përbëhet prej 3 blloqeve: blloku i parë ka të bëjë me kriteret politike, blloku i dytë me kriteret ekonomike dhe blloku i tretë i cili ka të bëjë me standarde evropiane dhe përafrimin e Kosovës me Acqiun e BE-së.

Përcakton një kornizë gjithëpërfshirëse të reformave afatmesme (për periudhën e ardhshme pesëvjeçare: 2016-2020) për zbatimin e MSA-së dhe përfarimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE-së, si dhe zbatimin e legjislacionit të përafruar.

Pra, ai përmban masa afatshkurtra (që mbulojnë vitin 2016) dhe prioritetet afatmesme (që mbulojnë vitet 2017-2020), të ndara në dy kategori: masa e prioritetit legjislativ dhe masa e prioritetit zbatues.

Struktura e PKZMSA-së është e organizuar në dy pjesë: pjesa narrative dhe matrica e masave afatshkurtra.

Pjesa narrative e secilit kapitull përmbledh detyrimet e MSA-së dhe detyrimet e dala nga mekanizmat e tjerë të aderimit në BE, gjenden aktuale (kornizën ligjore, përfshirë nivelin e përafrimit të legjislacionit me *acquis*, kornizën e politikave, kornizën institucionale, dhe asistencën e jashtme), si dhe masat afatshkurtra dhe prioritetet afatmesme.

Në anën tjetër, matrica e masave afatshkurtra në kuadër të secilit kapitull përvijon në mënyrë të hollësishme masat konkrete që do të ndërmerren, të ndara në dy kategori: masa legjislativ dhe masa zbatuese.

Secili organ i administratës shtetërore do të jetë përgjegjës për zbatimin Programit dhe monitorimin e zbatimit të tij në kuadër të fushëveprimit të kompetencave të tij.

Kuvendi do të jetë një nga shtyllat kryesore institucionale në zbatimin e këtij programi, në veçanti miratimin e legjislacionit.

Rol kyç në kuadër të tij do të ketë Komisioni për Integrim Evropian, si në aspektin e shtyrjes përpara të agjendës legjislativ, ashtu edhe atë të koordinuesit për monitorimin e përmbushjes së detyrimeve të marra përsipër nga Kuvendi.

Në pjesën tabelare duhet të bëhet një përmirësim, te kapitulli 10 i *acquis*: Shoqëria e informacionit dhe mediat, pika 3.11, si Institucion Përgjegjës, në vend të Kuvendit duhet të jetë ARKEP.

Në vazhdim tha se duke pas parasysh se ky program është mjaft voluminoz dhe kërkuar, ne, si komision, do ta organizojmë një takim me shoqërinë civile dhe të gjithë faktorët e tjerë relevant që kanë rol në PKZMSA. Lidhur me këtë falënderoi Grupin për Studime Juridike dhe Politike për kontributin e dhënë nëpërmjet inputeve të tyre dhe për organizimin e takimit me shoqërinë civile dhe të tjerët, presim që inputet që do të dalin prej takimit do të jenë shumë të vlefshme dhe do të ndihmojnë në zbatimin e MSA-së.

Lidhur me këtë hapi diskutimin dhe kërkoi që të miratohet me PKZMSA me ndryshimin e propozuar te kapitulli 10- të.

Kryetarja konstatoi se komisioni një zëri miratoi Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit (PKZMSA) me ndryshimin e propozuar.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-060 për Mjekësin Ligjore, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja lidhur me këtë projektligj paraqiti opinionin ligjor, duke konstatuar se fusha e cila rregullohet me këtë projektligj, nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë mund të rekomandohet për miratim në procedim të rregullt në Kuvend

Lidhur me këtë Projektligj hapi debatin.

Meqë nuk kishte vërejtje në Projektligj dhe Raportin e Komisionit Funkcional me amendamentet e propozuara, kryetarja konstatoi se Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Projektligjit nr. 05/L-060 për Mjekësin Ligjore, nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së.

Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL nuk janë në kundërshtim me parimet bazë të Acquis Communitare.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor lidhur me këtë projektligj së bashku me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, duke konstatuar se fusha me të cilën rregullohet ky Projektligj nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së dhe mbetet kompetencë e brendshme e shteteve anëtare, por ekzistojnë akte legjislative që i referohen procedurës administrative në aspektin e parimit të proporcionalitetit mes autoritetit publik dhe lirive dhe të drejtave të njeriut. Andaj si i tillë mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt Kuvend.

Lidhur me këtë projektligj hapi debatin.

Meqë nuk kishte vërejtje në Projektligj dhe Raportin e Komisionit FunkSIONAL me amendamentet e propozuara, kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligjit nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së.

Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL nuk janë në kundërshtim me parimet bazë të Acquis Communitare.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-07 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor lidhur me këtë projektligj së bashku me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, duke konstatuar se fusha me të cilën rregullohet ky Projektligj nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së dhe mbetet kompetencë e brendshme e shteteve anëtare dhe mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt Kuvend. Në vazhdim tha se për hir të informimit edhe pse nuk ka të bëjë me acquis dhe përputhshmëri, por ka qenë edhe kërkesë e shumë qytetarëve që në këtë Projektligj, neni 69 të riformulohet dhe lexoj amendamentin „**Dëmet e lejueshme**”.

Gjykata kompetente është e autorizuar që ta urdhërojë një autoritet publik, ose organizatë buxhetore, që të bëjë kompensimin në të holla për dëmet e shkaktuara materiale dhe jo materiale, të cilat janë vërtetuar nga gjykata, në bazë të provave me aktgjykim të formës së prerë.

Pasi që nuk kishte vërejtje në Projektligj dhe Raportin e Komisionit FunkSIONAL me amendamentet e propozuara, kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 05/L-07 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së.

Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL nuk janë në kundërshtim me parimet bazë të Acquis Communitare.

8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-064 për Patentë -shofer, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor lidhur me këtë projektligj së bashku me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, duke konstatuar se ky Projektligj nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, përkatësisht Acquis të BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt Kuvend.

Pasi që nuk kishte vërejtje në Projektligj dhe Raportin e Komisionit FunkSIONAL me amendamentet e propozuara, kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 05/L-064 për Patentë -shofer nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL nuk janë në kundërshtim me parimet bazë të Acquis Communitare.

9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor lidhur me këtë projektligj së bashku me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL duke konstatuar se fusha e cila rregullon ky projektligj nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Pasi që nuk kishte vërejtje në Projektligj dhe Raportin e Komisionit FunkSIONAL me amendamentet e propozuara, kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 05/L-049 për administrimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e BE-së

Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL nuk janë në kundërshtim me parimet bazë të Acquis Communitare.

10. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-062 për siguri në punë në veprimtarinë minerare, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor lidhur me këtë projektligj së bashku me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL duke konstatuar se ky Projektligj nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Pasi që nuk kishte vërejtje në Projektligj dhe Raportin e Komisionit FunkSIONAL me amendamentet e propozuara, kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligjit nr. 05/L-062 për siguri në punë në veprimtarinë minerare nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së.

Amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL nuk janë në kundërshtim me parimet bazë të Acquis Communitare.

Të ndryshme

Kryetarja tha se i kishte disa çështje për diskutim në të cilat kërkohet edhe miratimi i komisionit.

Ajo tha se në takimet e kaluara kemi diskutuar që gjatë janarit kur ishim për vizitë në Bruksel, nga Parlamenti Evropian kemi marrë një propozim që të formohet grupi i miqësisë në mes të Kosovës dhe Parlamentit Evropian dhe komisioni ynë do të jetë komision që do ta iniciojë dhe do të kërkojë krijimin e tij dhe besoj që ky Grup i miqësisë do ta ngritë bashkëpunimin tonë dhe shkëmbimin e informatave në mënyrë ma cilësore me Parlamentin Evropian.

Andaj kërkoj nga komisioni miratimin që të bëhet kërkesa në Kryesi për formimin e grupit të miqësisë në mes të Kosovës dhe Parlamentit Evropian.

Kryetarja konstatoj se Komisioni një zëri miratoi që t'i drejtohet kërkesa Kryesisë së Kuvendit për formimin e Grupit të miqësisë në mes të Kosovës dhe Parlamentit Evropian.

Në vazhdim për pikën tjetër të diskutimit tha se është pikë që është diskutuar mjaft edhe vitin e kaluar, e që kishte të bëjë me ftesën që i është bërë komisionit homolog në Shqipëri dhe dy herë në momentet e fundit janë anuluar vizitat për shkak të zgjedhjeve dhe çështjeve të tjera.

Në javën e tretë të Marsit kemi marrë konfirmimin se do të vijnë në vizitë, andaj edhe një herë kërkoj aprovimin e Komisionit për të filluar procedurat për realizimin e vizitës.

Pasi nuk ishte askush kundër, kryetarja konstatoi se komisioni u pajtua që të fillohet me procedura për pritjen e delegacionit të komisionit homolog të Shqipërisë.

Xhavit Haliti - Theksoi se ekziston një marrëveshje mes parlamentit të Kosovës dhe Shqipërisë që komisionet kryesore të këmbëjnë vizita pune edhe jo protokollare, sepse ne duhet ta këmbëjmë përvojën dhe duhet ta kemi asistencën e tyre, sepse nëpër procese që tani po kalojmë ata veç i kanë kaluar dhe kryetarja e Komisionit duhet të komunikojë drejtpërdrejt me kryetaren e komisionit të Shqipërisë dhe të ftohen duke iu krijuar kushte për punë, për t'i këmbyer përvojat që duhet t'i praktikojmë si Parlament dhe si komision, në veçanti çështja e bashkëpunimit të delegacioneve tona në fusha të caktuara edhe kur kemi kontakt dhe kur jemi të pranishëm bashkë në konferencat ndërkombëtare.

Në vazhdim vlerësoi se në të njëjtën formë duhet me bashkëpunuar edhe me Maqedoninë dhe me komisionet për integritet me shtetet e tjera fqinje dhe për t'i përafëruar delegacionet njeri me tjetrin, ne po përballemi kryesisht me delegacionin e Serbisë nëpër institucionet ndërkombëtare, ku në të shumtën e rasteve janë bërë pengesë e madhe lobuese për ta penguar Kosovën, por në disa mekanizma ndërkombëtar ka funksionuar kjo mënyra e njohjes me njëri-tjetrin.

Ne jemi duke pretenduar të hyjmë në Evropë dhe Evropa dëshiron që ne të komunikojmë, të bashkëpunojmë dhe të funksionojmë si rajon dhe të fillojmë me ata që e kemi më lehtë dhe të vazhdojmë përmes tyre t'i lehtësojmë vështirësitë me ata që e kemi më vështirë.

Kryetarja lidhur me takimet me komisionin homolog të Shqipërisë tha se ka pas komunikim të drejtpërdrejtë, por se patjetër që duhet të ngrihet në një nivel më të lartë dhe takimet t'i kemi më të shpeshta dhe sidomos MSA do të duhej të na bashkojë edhe me Komisionin homolog edhe nga Maqedonia dhe koordinimi në takimet në Parlamentin Evropian dhe Këshillin e Evropës që i përkasin rezolutave dhe vendimeve që kanë të bëjnë për Kosovën.

Sa i përket takimeve njoftoi se gjatë vizitës që e kishte komisioni në Parlamentin Evropian ju është kërkuar që brenda këtij muaji ose fillimi i muajit të ardhshëm të bëhen vizita në disa shtete në të cilat ka luhatje, sa i përket liberalizimit të vizave. Konkretisht u sugjeruan që Komisioni për Integritet Evropian të vizitojë: Francën, Austrinë, Gjermaninë, Suedinë dhe Italinë të cilët po përballen me fluks të madh të refugjatëve dhe kjo ka shkaktuar luhatje në përkrahje për liberalizim të vizave, andaj kërkoi miratimin e komisionit që të procedohet me këto kërkesa sa i përket ndihmës për liberalizimin e vizave.

Pasi që komisioni nuk kishte vërejtje kryetarja konstatoi se komisioni një zëri miratoi që të procedohet me kërkesa për të vizituar shtetet sa i përket ndihmës për liberalizimin e vizave.

Në vazhdim tha se në muajin shtator kemi pasur vizitën kthyesë të Komisionit për Çështje Evropiane të Senatit Italian dhe kryetari i këtij komisioni senatori Vanino Kiti ka kërkuar të nënshkruhet një memorandum mirëkuptimi mes dy komisioneve në mënyrë që të koordinohemi rreth çështjeve të ndryshme në nivel komunikimi që ngrit në nivel të lartë bashkëpunimin mes dy komisioneve.

Kujtim Paqaku - Tha se pajtohet me diskutimet e z. Haliti dhe znj. Sahatqija, por mendon se duhet bërë kontakte edhe me ato shtete që ishin në luhatje kur Kosova nuk hyri në UNESCO dhe nuk e kanë votuar Kosovën, sepse kanë marrë informata të gabuara prej Serbisë për Kosovën dhe është përdorë një reklamë e vrazhdë ndaj Kosovës dhe na kanë befasuar disa shtete që na kanë njohur dhe nuk na kanë votuar. Pra të kontaktojmë me këto shtete dhe t'i kthejmë të anojnë kah Kosova.

Kryetarja e vlerëson si ide të mirë, por tha se lobimi me këto shtete është detyrë e gjithë Kuvendit në përgjithësi, por barra më e madhe i bie Komisionit për punë të jashtme.

Xhavit Haliti u ndërlidh në diskutim dhe tha se sa i përket çështjes së UNESCO-së, shumë herë në media dalin gjëra të cilat nuk janë shumë herë të sqaruara sa duhet dhe ne e kemi një problem i cili duhet të tejkalohet dhe ka të bëjë me ndryshimin e ligjit mbi trashëgiminë kulturore fetare etj. në Kosovë, sepse është një ligj i cili është i kontestuar edhe nga BE-ja dhe faktor të caktuar që kanë pasur si argument të fuqishëm pengimin e Kosovës për t'u bërë anëtare e UNESCO-së. Së pari duhet rregulluar pjesa ligjore e kontestuar e Kosovës dhe nuk ka nevojë me u bë zhurmë shumë para se të kryhen punët. Ne kemi pasur bërë fushat të madhe për pranimin në UNESCO, por nuk varet nga fushata dhe propaganda që bëjmë ne, por varet prej vlerësimit nga vota dhe bindjet e tyre për të votuar, për t'i bindur ata që të votojnë atëherë çështja e legjislacionit duhet rregulluar.

Kryetarja në vazhdim ngriti çështjen e monitorimit të zbatimit të Ligjit për kompetencat e zgjeruara dhe konfiskimin e pasurisë së përfutur me vepër penale. Lidhur me këtë ajo sqaroi se grupi punues, i udhëhequr nga deputeti Ilir Deda, ka bërë monitorimin e këtij ligji dhe raporti është dashur të dorëzohet në Kuvend për miratim në muajin nëntor, por nuk ekziston vullneti i opozitës dhe ne nuk mund ta mbajmë peng këtë ligj.

Andaj kërkoj nga komisioni që ta miratojë propozimin që raporti për këtë Ligj të vihet në rend dite për miratim në mbledhjen e radhës dhe pastaj të procedohet për seancë në Kuvend.

Pasi nuk kishte kundërshtime nga anëtarët, kryetarja konstatoj se komisioni një zëri miratoj propozimin që në mbledhjen e radhës të vihet në rend dite raporti për mbikëqyrjen e Ligjit për kompetencat e zgjeruara dhe konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale.

Xhavit Haliti -Tha se ne duhet të dimë se sa është duke u zbatuar Ligji për përgjime të telekomunikimeve dhe kush është përgjegjës për të na raportuar në Komision, ministri i Integrimeve Evropiane nuk është kompetent me radhë me raportuar në komision, por ministria përkatëse të vij dhe në mënyrë të detajuar të raportojë për komisionin dhe të na njoftojnë se a janë marrë masat e duhura. Askund në botë nuk praktikohet metoda e monitorimit të ligjit si te ne. Ne duhet ta thërrasim Qeverinë në komision, e jo të shkojmë e t'i pyesim nëpër zyre se a po zbatohet ligji, askush nuk do të na thotë se nuk po zbatohet.

Kryetarja- Tha se në muajin maj është paraparë formimi i Grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për përgjime të telekomunikimeve dhe kjo ka qenë edhe kërkesë e shoqërisë civile që në cilësinë e Komisionit FunkSIONAL ta bëjmë monitorimin.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Teuta Sahatqija